

V E N D I M
Nr.73, datë 28.2.1994

PËR SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.195, DATË 16.4.1993
“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.284, DATË
25.6.1992 “PËR RIFILLIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT”

Me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Keshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.195, datë 16.4.1993 në pikën 1, pas fjalëve “dhe rregullimit të territorit” shtohen fjalët “edhe parqet automobilistike të sistemit të Ministrisë së Burimeve Minerare e Energjetike dhe të Ministrisë së Industrisë e të Tregtisë, si dhe ndërmarrjet e bonifikimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi